



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



EKONOMIA DHE BUXHETI

NËNTOR 2008

Raporti Mujo

Nëntor, 2008

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 225 8437

e-mail: elami@minfin.gov.al

www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi mesatar i këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	7
7. Oferta e Parasë	8
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Deficitit	12
ANEKSI STATISTIKOR.....	13


VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Nëntor, 2008 arriti në 101.3 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Nëntor ishte 2.6 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Nëntor 2008 ishte 96.84 lekë për dollarë dhe 123.29 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Nëntor shënuan kuotat 6.92 përqind për depozitat 24 mujore, 6.82 për ato 12 mujore, 5.95 për 6 mujorët dhe 5.09 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 12.05 përqind për huatë 12 mujore dhe 13.44 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 800 miliardë lekë në muajin Nëntor, duke shënuar një rritje prej rreth 12.1 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për 9 – muajorin e 2008* rezultoi me një sufiçit të përgjithshëm prej 101.5 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Nëntor, 2008 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 23.9 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara* në Janar - Nëntor, 2008 arritën në rreth 262.5 miliardë lekë ose rreth 86.4 përqind e planit vjetor 2008
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 284.3 miliardë lekë ose rreth 78.9 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2008

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Nëntor 2008 pësoi një rënie prej 0.1 përqind krahasuar me muajin Tetor dhe Shtator, kur ky indeks shënonte përkatësisht 0.1 përqind dhe 1.1 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë



ishin 0.2 përqind, -0.1 përqind dhe 0.9 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit Nëntor u konstatua në grupin “Veshje dhe këpucë” 0.6 përqind, rritje e cila erdhi si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të nëngrupit “Këpucë” me 1.2 përqind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ndieshme mbi normën e inflacionit.

Gjatë këtij muaji rënie më të madhe prej 2.5 % e pësoi indeksi i çmimit të grupit “Transporti”.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
2008	3.0	3.6	4.6	4.4	4.2	4.0
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2007	2.1	4.2	4.4	4.2	3.5	3.1
2008	3.7	2.5	2.7	2.8	2.6	

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Nëntor arriti në 2.6 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2007 dhe 2008 paraqiten në tabelën 1.

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Nëntor 2008, arriti në 123.29 Lekë/Euro, duke shënuar një rritje prej 0.13 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Nëntor një euro u këmbye me 123.37 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Nëntor 2008, arriti në 96.84 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 0.23 përqind kundrejt muajit Tetor. Në fund të muajit Nëntor, dollari amerikan arriti nivelin 98.33 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Nëntor të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është zhvlerësuar ndaj dollarit amerikan në




Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Nentor '08

masën 16.7 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 1.2 përqind. Nënçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 1.273 euro/dollarë.


Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetin e politikës fiskale, efikasitetin në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarrura nga Banka e Shqipërisë, flukse hyrëse të valutës së huaj gjatë kësaj kohe etj.

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Nëntor 2008, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 6.82 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.08 përqind në krahasim me muajin tetor ku normat e interesit shënonin vlerën 6.90 përqind. Rënie për këtë muaj kanë pësuar depozitat me afat 1-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.11 përqind, normat e interesit për depozitat me afat 6 – mujor u rritën me 0.19 përqind, si dhe normat e depozitave me afat 3 – mujor me 0.07 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Nëntor pësoi një rënie 0.41 pikë përqind, duke arritur në 12.05 përqind nga 12.46 përqind që ishte në muajin tetor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 0.45 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Nëntor arriti në 13.44 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Nëntor 2008, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 8.10 përqind, 7.42 përqind dhe 6.05 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6 mujor.




Normat e interesit për depozitat me afat 6 – mujor u rritën me 0.19 përqind, si dhe normat e depozitave me afat 3 – mujor me 0.07 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Nëntor pësoi një rënie 0.41 pikë përqind, duke arritur në 12.05 përqind nga 12.46 përqind që ishte në muajin tetor. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 0.45 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Nëntor arriti në 13.44 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Nëntor 2008, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3 mujor, ishin përkatësisht 8.10 përqind, 7.42 përqind dhe 6.05 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6 mujor.



Gjatë këtij muaji vihet re një rritje në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6 mujor.


4. Bilanci i Pagesave



Bilanci i Pagesave

Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Shtator 2008 regjistroi një sufiçit të përgjithshëm prej 101.5 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.




Llogaria Korente

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiçitit të llogarisë korente prej 842.4 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'08 - shtator'08 rezultoi: (i) bilanci tregtar - 1,689.3 mln euro, (ii) shërbime neto -8.5 mln euro, (iii) të ardhura neto 192.5 mln euro, (iv) transferta neto 663.0 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Nëntor 2008, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 6,615.1 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2007. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 41,283.2 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 47,898.3 milionë



lekë. Në muajin Nëntor sistemi bankar rezulton me një rritje prej 4,052.2 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin tetor, rritje e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 12,546.1 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 16,598.3 milionë lekë.

6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Nëntor 2008 arriti në 395 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2007 shënoi vlerën 101.4 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 34.5 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në vitin 2007.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 71.8 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 284 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 35.5 përqind.


7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Nëntor ka shënuar një rënie krahasuar me muajin paraardhës Tetor. Kjo ofertë arriti në rreth 800 miliardë lekë në fund të muajit Nëntor duke shënuar një rritje prej 42.7 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në




muajin Dhjetor 2007. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 12.1 përqind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 8.3 përqind, rritjes së depozitave në valutë me rreth 13.6 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 5.0 përqind dhe rritjes të parasë jashtë sistemit me rreth 21.2 përqind.

Ndikimin kryesor në rënie e ofertës monetare gjatë muajit Nëntor e kanë patur rënia e depozitave me afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u ulen me rreth 7.2 miliardë lekë, rënies së depozitave në valutë me 10.5 miliardë lekë, si dhe rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 2.2 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit Nëntor arriti në 21.6 përqind duke shënuar një rritje në krahasim me muajin tetor. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Nëntor arriti në rreth 27.7 përqind, duke shënuar një rritje prej 1.9 përqind e krahasuar me muajin tetor.



Graf - 10




Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 4.9 miliardë lekë në krahasim me muajin tetor.

Raportet të parashë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Graf - 11



Depozitat në valutë gjatë muajit Nëntor, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 74.6 përqind të depozitave totale në valutë.

Raporti i Depozitave ndaj M3


Burimi: Banka e Shqipërisë

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Nëntor 2008 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 47.7 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 41.0 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 8.6 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 74.6 përqind dhe rreth 20.7 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i

rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.1 përqind e totalit)

Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 502 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 625 miliardë lekë në muajin Nëntor 2008. Ata ndiqen nga sektori privat (99.3 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (17.2 miliardë) dhe autoritetet lokale (2.8 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 3.8



Përberja e depozitave


Burimi: Banka e Shqipërisë

miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit Nëntor 2008, krahasuar me një muaj më parë tetor, niveli i përgjithshëm i depozitave u ul me 15.5 miliardë lekë, si rezultat i rënies së depozitave në valutë dhe atyre në lekë.

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar - Nëntor, janë mbledhur rreth 262.4 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 284.3 miliardë lekë, që përfshijne 212.8 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 69.1 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga



Treguesit Fiskal, Nentor 2008

të cilat 46 % financim i brendshëm, dhe 54 % financim i huaj. Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 86.4 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2008, ndërsa shpenzimet përbëjnë 78.9 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 82.5 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 73.2 % e këtij planifikimi. Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 185.9 miliardë lekë (ose rreth 88.6 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 10.3 miliardë lekë (66.4 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 43.1 miliardë lekë (84.49 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jokatimore në nivelin e 21.6 miliardë lekë (94.9 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 212.8 miliardë lekë, 58 miliardë lekë (27.3 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 28.6 miliardë lekë (13.4 %) për interesat, 22.2 miliardë lekë (10.4 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.8 miliardë lekë (0.8 %) për subvencione, 68.1 miliardë lekë (32%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 22.3 miliardë lekë (10.5 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 11.8 miliardë lekë (5.5 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 85.4 % (shpenzime personeli), 87.8 % (shpenzime për interesat), 77.4 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 91 % (subvencione), 86.6 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 70.6 % dhe 76.1 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrajt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 65.1 % të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 81.9 %.

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Nëntor 2008 ishin rreth 262.4 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 239.4 miliardë, grantet 1,491 milionë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 21.6 miliardë

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar - Nëntor 2008

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	97.6
Tatimi mbi fitimin	16.8
Taksa doganore	7.8
Taksat nacionale	13.3
Akcizat	29.9
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	4.5

3. Financimi i Deficitit

Deficiti prej 21.9 miliardë lekë, për periudhën Janar-Nëntor, u mbështet në vlerën 11 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 33.1 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Nëntor disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 27.4 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 32.5 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 16.8 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 21.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 10.6 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit

Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)				Mesatar Mujor (Monthly Average)				Vjetor (Annual)				Month
	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	
Janar	0.8	0.2	0.5	0.5	0.80	0.20	0.50	0.50	3.3	1.4	2.9	3.0	January
Shkurt	0.4	0.4	0.5	1.0	0.60	0.30	0.50	0.75	1.8	1.3	2.9	3.6	February
Mars	0.0	0.1	-0.1	0.9	0.40	0.23	0.30	0.80	1.6	1.5	2.7	4.6	March
Prill	-0.3	0.6	-0.2	-0.4	0.23	0.33	0.18	0.50	1.3	2.4	1.9	4.4	April
Maj	-1.1	-0.4	-0.8	-1.0	-0.04	0.18	-0.02	0.20	2.0	3.1	1.4	4.2	May
Qershor	-0.5	-1.1	-0.6	-0.8	-0.12	-0.03	-0.12	0.03	2.9	2.4	2.0	4.0	June
Korik	-1.2	-0.4	-0.3	-0.6	-0.27	-0.09	-0.14	-0.06	1.8	3.2	2.1	3.7	July
Gusht	0.2	-0.2	1.9	0.6	-0.21	-0.10	0.11	0.03	2.3	2.8	4.2	2.5	August
Shtator	0.9	0.6	0.9	1.1	-0.09	-0.02	0.20	0.14	3.1	2.6	4.4	2.7	September
Tetor	0.4	0.1	-0.1	0.1	-0.04	-0.01	0.17	0.14	3.3	2.2	4.2	2.8	October
Nendor	0.2	0.9	0.2	-0.1	-0.02	0.07	0.17	0.12	3.0	2.9	3.5	2.6	November
Dhjetor	2.2	1.8	1.3		0.10	0.22	0.27		2.0	2.5	3.1		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2 **Kursi i kembimit**
Exchange rate

Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008											Currency
									Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	
<i>Mesatarja e periudhes</i>																			<i>Average of period</i>	
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	90.43	83.39	83.90	80.32	77.79	78.45	78.46	77.24	81.12	85.65	92.62	96.84	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	123.63	122.61	123.69	124.59	122.68	122.08	122.03	121.87	121.44	123.05	123.13	123.29	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>																				<i>In the end of period</i>
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	82.89	82.61	82.58	78.29	78.94	78.65	77.17	78.01	82.66	86.38	96.78	95.33	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	121.78	122.61	125.34	123.70	122.75	122.01	122.05	121.80	121.70	123.89	123.30	123.37	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me baze vjetore

Annual Interest Rates

		2008												
Ne perqindje	Dhjetor 07	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	In percent	
Fundi I periudhes	Dec	Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	End of period	
Norma e remunerimit													Remuneration rate	
ne leke	-	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	In Lek	
ne usd	-	2.30	2.19	1.87	2.02	1.87	1.72	1.73	0.70	In USD	
ne euro	-	2.92	2.93	3.07	3.07	3.07	3.14	3.14	2.63	in EURO	
Norma e depozitave													Deposits rates	
12-M	6.33	6.49	6.10	6.11	6.41	6.72	6.65	7.72	7.71	7.25	6.90	6.82	12-M	
6-M	5.50	5.56	5.44	5.42	5.64	5.61	5.76	5.99	6.09	5.81	5.76	5.95	6-M	
3-M	4.85	5.08	4.80	4.84	5.08	4.96	5.00	5.21	6.27	5.08	5.02	5.09	3-M	
1-M	3.21	3.59	3.48	3.58	3.62	4.36	4.61	4.63	5.09	4.89	4.84	4.73	1-M	
Norma e huase													Lending rates	
12-M	13.55	13.36	11.78	11.48	12.92	11.50	11.40	11.45	12.32	10.84	12.46	12.05	12-M	
6-M	13.85	15.53	14.29	13.50	12.40	12.40	13.66	12.49	12.04	12.32	12.99	13.44	6-M	
Norma e letrave me vlere													Securities rates	
Bobo thesari 1/													Treasury bills 1/	
3-M	6.48	6.20	6.26	6.25	6.29	6.28	6.27	6.28	6.26	6.24	6.23	6.05	3-M	
6-M	7.51	7.30	7.29	7.36	7.47	7.48	7.46	7.46	7.39	7.33	7.20	7.42	6-M	
12-M	8.41	8.14	8.00	8.02	8.12	8.16	8.19	8.21	8.15	8.02	7.94	8.10	12-M	

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2008
Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2008

ne milion leke (in million leks)

Te dhena progresive (Progressive Data)													
Nr.	E M E R T I M I	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Tetor Oct	Nentor Nov	ITEM	No.	
	TOTALI TE ARDHURAVE	63,594	87,807	111,542	134,889	161,135	184,974	208,922	235,074	262,447	TOTAL REVENUE		
I.	Ndihma	41	250	466	521	623	705	721	731	1,491	Grants	I.	
II.	Te ardhura tatimore	60,420	82,618	103,004	123,998	147,274	170,124	192,617	217,757	239,365	Tax Revenue	II.	
II.1.	Nga Tatimet dhe Doganat	46,867	62,853	79,253	96,093	113,410	131,902	149,942	169,048	185,879	From tax offices and customs	II.1	
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	24,021	32,423	40,714	49,745	59,085	68,206	77,998	88,551	97,617	V. A T	1	
2	Tatimi mbi Fitimin	6,052	7,305	8,646	9,839	10,876	12,282	13,474	14,842	16,757	Profit Tax	2	
3	Akcozat	6,518	9,070	12,044	14,940	17,737	21,804	24,880	27,738	29,989	Excise Tax	3	
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	4,817	6,563	8,332	9,996	12,349	14,258	16,259	18,579	20,399	Personal Income Tax	4	
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	3,400	4,656	5,966	7,309	8,410	9,696	10,990	12,238	13,299	National Taxes and others	5	
6	Taksa Doganore	2,059	2,835	3,550	4,264	4,953	5,657	6,340	7,101	7,818	Custom Duties	6	
II.2.	Te ardhura nga Pushteti Lokal	2,422	4,345	4,858	5,462	7,106	7,740	8,399	9,605	10,344	Revenues from Local Gov.	II.2	
1	Taksa Lokale	1,677	3,160	3,570	4,050	5,290	5,869	6,414	7,220	7,882	Local Taxes	1	
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	745	1,185	1,289	1,412	1,816	1,871	1,985	2,385	2,462	Small Business Tax	2	
II.3.	Te ardh. Buxh. Pavarur	11,131	15,420	18,893	22,443	26,758	30,482	34,277	39,103	43,142	Social ins.	II.3	
1	Sigurimi Shoqeror	9,930	13,776	16,875	20,048	23,918	27,282	30,676	35,017	38,645	Social Insurance	1	
2	Sigurimi Shendetesor	1,201	1,644	2,018	2,395	2,841	3,200	3,600	4,086	4,497	Health insurance	2	
III.	Te ardhura Jotatimore	3,133	4,939	8,072	10,371	13,238	14,146	15,584	16,587	21,591	Nontax Revenue	III.	
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqiperise	0	0	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	4,500	Profit transfer from BOA	1	
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	2,948	4,355	5,419	6,427	6,935	7,771	8,570	9,148	11,037	Income of budgetary institutions	2	
4	Te tjera	185	584	1,153	2,444	4,803	4,875	5,513	5,938	6,053	Other/not allocated	4	
	TOTALI I SHPENZIMEVE	53,098	78,466	105,621	137,320	166,722	193,878	217,317	251,860	284,341	TOTAL EXPENDITURE		
I.	Shpenzime Korrente	48,032	67,306	87,291	107,787	129,752	149,778	169,539	190,962	212,829	Current Expenditures	I.	
II.	Personel	14,172	19,631	24,700	29,991	35,646	40,912	46,344	52,083	58,033	Personnel expenditures	II.	
1	Paga	11,730	16,307	20,546	24,946	29,743	34,147	38,662	43,548	48,448	Wages	1	
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	2,442	3,324	4,154	5,045	5,904	6,765	7,682	8,535	9,585	Social insurance contributions	2	
3	Politikat e reja pagash										Of which: Contingency	3	
I.2.	Interesat	6,926	9,190	12,359	15,021	18,758	21,065	22,994	25,505	28,599	Interest	I.2	
1	Te Brendshme	6,578	8,714	11,304	13,636	17,308	19,383	21,177	23,316	25,975	Domestic	1	
2	Te Huaja	348	476	1,055	1,385	1,451	1,682	1,818	2,189	2,624	Foreign	2	
I.3.	Shpenzime Operative Mirembajtje	3,703	5,744	7,856	10,451	12,804	14,615	16,624	19,619	22,182	Operational & Maintenance	I.3	
I.4.	Subvencionet	207	287	700	884	961	1,388	1,506	1,595	1,791	Subsidies	I.4	
I.5.	Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera	16,640	22,642	28,623	35,022	41,796	48,759	55,423	61,908	68,130	Social insurance outlays	I.5	
1	Sigurime Shoqerore	14,400	19,554	24,641	30,154	36,002	42,098	47,917	53,527	58,822	Social insurance	1	
2	Sigurime Shendetesore	2,240	3,088	3,983	4,868	5,794	6,661	7,506	8,380	9,308	Health insurance	2	
I.7.	Shpenzime per Buxhetin Lokal	3,776	6,105	8,222	10,469	12,723	14,812	17,196	19,618	22,338	Local Budget	I.7	
I.8.	Shpenzime te tjera	2,608	3,707	4,831	5,950	7,062	8,227	9,452	10,634	11,756	Other expenditures	I.8	
1	Pagesa e Papunesise	193	260	344	425	499	567	633	697	755	Unemployment insurance benefits	1	
2	Ndihma Ekonomike	2,415	3,448	4,486	5,524	6,563	7,660	8,819	9,936	11,001	Social assistance	2	
3	Kompensim per ish te permdjekurit politike										Compensation for ex political prisoners	3	
I.9.	Kompensim ne vlere i pronareve										Property Compensation	I.9	
III.	Fondi Rezerve										Reserve fund/contingency	III.	
III.	Shpenzime Kapitale	5,066	10,262	16,984	28,016	34,744	41,816	45,450	58,531	69,135	Capital expenditures	III.	
1	Financimi Brendshem	4,345	5,882	8,262	11,307	13,648	16,639	19,376	22,895	27,353	Domestically financed	1	
2	Financimi Huaj	721	4,380	8,722	16,709	21,096	25,177	26,074	35,635	41,783	Foreign financed	2	
IV.	Rindertimi i Gerdedit	898	1,346	1,517	2,227	2,284	2,328	2,367	2,376	2,376			
	DEFICITI	10,496	9,341	5,921	-2,431	-5,588	-8,904	-8,395	-16,786	-21,894	Overall Deficit		
	FINANCIMI DEFICITIT	-10,496	-9,341	-5,921	2,431	5,588	8,904	8,395	16,786	21,894	Deficit Financing		
	Brendshem	-10,589	-9,877	-7,225	-8,464	-5,931	-9,493	-10,313	-8,036	-11,192	Domestic		
	Te ardhura nga privatizimi	121	198	298	400	686	740	832	1,209	1,019	Privatization receipts		
	Hua-marje e brendeshme	5,450	5,100	6,563	10,517	5,856	9,305	10,569	5,184	1,134	Domestic Borrowing		
	Te tjera	-16,160	-15,175	-14,085	-19,381	-12,473	-19,537	-21,713	-14,430	-13,344	Other		
	I Huaj	93	536	1,303	10,896	11,519	18,396	18,708	24,822	33,086	Foreign		
	Hua afatgjate(e marre)	794	1,070	1,834	12,357	13,157	19,693	20,830	27,141	35,703	Long-term Loan(Drawings)		
	Ndryshimi i gjendjes se arkesh*	-178	35	38	145	139	609	506	627	773	Chang. of stat. Account*		
	Ripagesat	-523	-569	-569	-1,606	-1,778	-1,905	-2,628	-2,946	-3,390	Repayments		
	KAPITUL KRYESORE	- 10,589	- 9,877	- 7,225	- 8,464	- 5,931	- 9,493	- 10,313	- 8,036	- 11,192	Main indicators		
	Financimi i Brendshem i Deficitit	10,496	9,341	5,921	2,431	5,588	8,904	8,395	16,786	21,894	Domestically financed deficit		
	Deficiti Pergjithshem	5,509	7,221	9,731	12,579	15,038	18,277	21,146	22,804	24,988	Overall Balance		
	Te ardh. Shpen. nga Sig. Shoq. dhe Shend.										Soc. & health insur. contr.-outlays		

* "Ndryshimi i gjendjes se arkesh" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

Chang. of stat. Account stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2008
Expenditures by central institutions during the year 2008

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Ministry or Institution
	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov	
Totali	53,098	78,466	105,621	137,320	166,722	193,878	217,317	251,860	284,341	Total
Presidenca	33	44	59	69	83	93	104	124	206	President
Kuvendi	198	266	333	406	500	548	615	693	795	Parliament
Keshilli i Ministrave	66	100	127	130	157	176	192	331	365	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	172	375	512	586	651	720	809	908	1,014	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	574	891	1,226	1,673	2,256	2,580	3,143	3,656	4,158	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,219	8,566	14,771	24,299	29,913	36,680	39,217	50,403	59,455	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Ministria e Financave	1,034	1,509	1,911	2,401	2,819	3,216	3,652	4,250	4,786	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	6,237	8,825	11,634	14,551	17,455	19,941	22,614	25,814	28,793	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	274	435	587	775	898	1,032	1,174	1,342	1,528	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	4,713	6,778	8,722	10,834	12,839	14,928	16,928	19,396	21,954	Ministry of Health
Ministria e Drejtësisë	670	971	1,278	1,661	2,009	2,342	2,725	3,188	3,571	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	528	713	895	1,132	1,332	1,443	1,623	1,783	1,956	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	2,600	3,572	4,633	5,975	7,085	8,296	9,313	10,760	12,138	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	3,167	4,364	5,363	6,974	8,286	9,302	10,638	11,996	13,216	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ i Shtetit	232	315	393	475	564	643	743	858	957	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	101	132	191	228	262	302	335	370	465	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	26	44	52	64	88	98	113	125	136	General Directorate of Archive
Akademia e Shkencave										Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	53	71	90	111	131	156	177	198	222	State Audit Commission
Ministria e Punes, Doshetjeve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	16,346	22,385	28,420	34,830	41,721	48,790	55,727	62,375	68,702	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	209	344	435	569	676	768	883	1,112	1,242	Ministry of Environment, Forstry & Water Administration
Prokuroria e Pergjithshme	200	278	354	444	525	601	680	785	883	State Prosecutor
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	250	348	450	543	678	761	852	975	1,097	Office for the Administration of the Judiciary Budget
Gjykata Kushtetuese	18	26	34	44	60	62	67	77	87	Constitutional Court
Ajensia Telegrafike Shqiptare	36	37	47	54	63	70	78	86	98	Albanian Press Agency
Shpenzime per sherbimin e borshit	6,926	9,190	12,359	15,021	18,758	21,065	22,994	25,505	28,599	Dept Service
Instituti i Statistikes	39	51	69	81	94	107	123	149	171	Statistics Institute
Autoriteti i Mbrojtjes Financiare	8	10	13	13	13	13	13	13	13	Securities Commission
Shkola e Magistratures	11	15	18	24	32	35	39	44	48	School of the Magistrate
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	119	215	265	378	522	586	615	672	701	Rural Development Program
Qendra Kombetare Kinematografike	8	40	70	90	96	103	107	132	142	National Movies Center
Instituti i integrimit te perndjekurve	7	11	13	16	19	23	25	29	31	Institute of integration of the ex political prisoners
Inspektoria e keshillit te larte te drejtesise	16	22	27	39	45	47	52	57	64	Inspection of the high Council of Justice
Avokati i popullit	20	31	37	45	59	61	66	74	81	Ombudsman
Komisioni i Sherbimit Civil	8	11	14	17	22	25	27	32	36	Commission of civil service
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	23	31	37	44	53	59	67	73	84	Central Committee for Elections
Entet Lokale "Granti"	3,776	6,105	8,222	10,469	12,723	14,812	17,196	19,618	22,338	Local Entities "Grant"
Inspektoria e Larte Kontr. Deklar te Pronave	12	21	32	39	46	51	57	66	73	High Inspectorate for Declaration of Properties & Assets
Autoriteti i Konkurences	10	18	21	25	29	34	41	43	52	Competition Authority
Ministria e Integrimit	24	33	44	53	67	74	81	91	110	Ministry of Integration
Ajentet tatimor jo-buxhetore	19	71	110	155	201	201	218	224	251	Tax agents not-budgetary
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	2	2	3.39	3.87	5	6	7	8	9	
Avokati i Prokurimeve	5	9	10.98	16.49	18	19	21	22	26	
Te tjera	108	1,191	1,741	1,961	2,871	3,007	3,162	3,422	3,712	
Te dhena operative										

Tab - 6 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL PER VITIN 2008
EXPENDITURES BY FUNCTIONS YEAR 2008

Te dhena progresive (Progressive Data) *ne milion leke (in million leks)*

Kodi	Funksionet	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Functions	Code
		Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	Oct	Nov		
	TOTAL	53,098	78,466	105,621	137,320	166,722	193,878	217,317	251,860	284,341	TOTAL	
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	12,438	17,329	22,917	28,161	34,647	39,209	43,735	49,090	54,802	General Public Services	01
02	Mbrojtja	1,840	2,511	3,026	4,181	4,968	5,557	6,320	7,113	7,793	Defense	02
03	Rendi dhe Siguria Publike	2,760	3,860	5,071	6,551	7,859	9,160	10,346	11,958	13,734	Public Order and Safety	03
04	Ceshtjet Ekonomike	5,253	10,562	16,932	27,270	33,815	40,616	44,260	56,575	66,763	Economic affairs	04
05	Mbrojtja e Mjedisit	18	29	35	46	53	73	81	157	172	Environmental protection	05
06	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	1,231	2,065	3,340	4,242	5,173	6,593	7,335	8,225	9,372	Housing and community amenities	06
07	Shendetesia	4,760	6,816	8,773	10,914	12,933	15,044	17,056	19,570	22,151	Health	07
08	Argetimi, Kultura dhe Ceshtjet Fetare	552	858	1,196	1,480	1,751	2,019	2,311	2,673	3,070	Recreation, culture and religion	08
